



# MANUAL PERDORIMI


## **PËRMBAJTJA**

ORGANIZIMI I APLIKACIONIT .....	4
1 IDENTIFIKIMI NË PROGRAM .....	5
1.1 Si do të logohemi .....	5
1.2 Si mund të ndryshojmë fjalëkalimin .....	5
1.3 Si të dalim nga aplikacioni.....	6
2 HARTA .....	7
2.1 Ndërveprimi me Hartën.....	8
2.2 Printimi.....	9
2.3 Filtri Gjeografik.....	11
2.4 Shpërnda .....	13
3 LEGJENDA.....	14
3.1 Legjenda.....	14
3.2 Transparenca.....	14
4 KERKIMI.....	15
4.1 Kërkimi i Shpejtë .....	15
4.2 Kërkimi i Avancuar .....	15
4.3 Raportë Fikse .....	16
4.4 Eksporti.....	17
5 EDITIMI .....	17
5.1 Butonat e Editimit të Gjeometrisë.....	17
5.2 Importi Shapefile .....	21
5.3 Eksporti Shapefile .....	22

# HYRJE

## ORGANIZIMI I APLIKACIONIT


Aplikacioni paraqitet në ekran si në figuren më poshtë dhe është i ndarë në disa seksionë sipas funksionëve të tyre.




**1** Seksioni lart, ka të shfaqur në të majtë butonin ku hapet **Manuali i Përdorimit**, më pas janë të reshtuar të gjithë objektët që ndodhen në aplikacion dhe në të djathtë ndodhet butoni i **Identifikimit**.

**2** Seksioni në qendër është **Harta** ku shfaqën të gjitha objektët që kanë gjeometri, në këtë seksion ndodhen dhe butonat e **Nderveprimit me Hartën** në të djathtë, butonat e **Filtrit Gjeografik** në pjesën e sipërme dhe butonat e **Editimit të Gjeometrise** si dhe **Import/Export-i** i një shapefile.


**3** Seksioni djathtas **Legjenda** përbëhet nga shtresat (Layer-at) dhe nënshtresat e saj sipas përdorimit që i kemi dhënë një objekti. Duke hapur dhe mbyllur këto shtresa mund të përfitojmë harta sipas përdorimit.

Butoni  (*Hap/Mbyll Legjenden*) ka si qëllim shfaqjen ose fshehjen e Legjendës duke klikuar mbi buton.

**4** Seksioni majtas, mundëson kërkim dhe filtrim të gjithë rekordeve për një objekt të caktuar. Gjithashtu në këtë seksion ndodhet dhe butoni **Raportë**, ku janë të listuar të gjitha raportët e parapërcaktuara si dhe butoni **Eksport**, ku mundëson ruajtjen e rekordeve në formatin excel të një kerkimi.

Butoni  (*Hap/Mbyll Legjenden*) ka si qëllim shfaqjen ose fshehjen e tabelës së kërkimit duke klikuar mbi buton.

**5** Seksioni në të majtë është **Editor-i** mundëson ndryshimin e të dhënave të një rekordi të zgjedhur. Gjithashtu në këtë seksion ndodhet dhe butoni i **Regjistrimit të një objekti të ri, Ndryshimit si dhe Fshirjes e një objekti.**

Butoni  (*Hap/Mbyll Editor-in*) ka si qëllim shfaqjen ose fshehjen e tabelës se editor-it duke klikuar mbi buton.

## 1 IDENTIFIKIMI NË PROGRAM


### 1.1 Si do të logohemi

Për të punuar në këtë aplikacion duhet të kemi një **Përdorues** dhe **Fjalëkalim** për të hyrë (log in). Kjo është e lejueshme vetëm për përdoruesit të cilët kanë të drejtën për të punuar apo për të ndryshuar informacionët që ata kanë hedhur.



### 1.2 Si mund të ndryshojmë fjalëkalimin

Pasi hapet faqja në të cilën keni hyrë, në krahun e djathtë lart të seksionit i log in-it, shfaqët përdoruesi me të cilin keni hyrë në aplikacion dhe një shigjetë për poshtë që pasi ta keni shtypur do t'ju shfaqët një tabelë tjetër ku mund të zgjidhni ndryshimin e fjalëkalimit ose dalje nga aplikacioni. Butoni **Ndrysho fjalëkalimin**. Shtypni këtë buton dhe do dalë një tabelë dialoguese e cila të jep të drejtën e ndryshimit të **Fjalëkalimit**. (mënyra se si procedohet është e ilustruar dhe në figurë).




Vendosni Fjalëkalimin e ri në fushat përkatëse. Në fund klikoni tek butoni **Ndrysho**.

Pasi të keni ndryshuar fjalëkalimin, aplikacioni do të rifreskohet duke ju kërkuar që të logoheni me përdoruesin ekzistues dhe fjalëkalimin e ri.

### 1.3 Si të dalim nga aplikacioni

Për të dale nga llogaria, klikoni tek butoni **Dalje** tek seksioni i **Log in** (tek i njëjti seksion ku u bë ndryshimi i **Fjalëkalimit**)

Pasi të keni mbaruar punë me aplikacionin gjithmonë shtypni butonin **Dalje** për tu siguruar që askush nuk do të ndryshojë të dhenat me Përdoruesin tuaj.





## 2 HARTA

ona Ndarja administrative sotir ▾

The screenshot shows a web GIS interface with a map of Albania. The map displays administrative boundaries and various geographical features. The legend on the right side of the map is as follows:


- Real estate
- Emertime
- Asig-Adresat
- Asig-Nomeklaturat
- Njësiti Statistike
- Asig-Administrative
- Asig-Kadastrale
- Asig-AKQP
- Asig-Gjeologji
- Asig-Inf.Urb./Sherbime
- Asig-Monumente Kulture
- Asig-Inf/Monit/Mjedis
- Asig-Burimet Minerare
- Asig-Sist/Transportit
- Asig-Burimet Energjetike
- Asig-Zonat e mbrojtura
- Asig-Mbulesa e Tokes
- Asig-AKPT
- Nomeklaturat
- Regj.Fill.(HTR-ZRPP)
- AQTN-500-Botim 1
- AQTN-500-Botim 2
- AQTN-500-Botim 3
- AQTN-1 000-Botim 1
- AQTN-1 000-Botim 2
- AQTN-2 000-Botim 1
- Kad. 5 000 vit.30-60
- Fondi Tokes vit.80-90
- Qytet-Vija verdhë(hist)
- Qytete-2500 Vitet 37-40
- Qytete-5000 Vitet 37-40
- Italiane-10 000 Vitet 30
- Italiane-50 000 Vitet 30
- Italiane-100 000 Vitet 30
- Italiane-300 000 Vitet 30
- Ruse-25 000 Vitet 50
- Ruse-50 000 Vitet 50
- Gjeologjike -200 000
- Hidro-Gjeologjike -200 000
- Asig-Topo-10000
- Asig-Topo-25000
- Asig-Topo-50000
- Asig-Topo-100000
- Asig-Topo-200000
- Ortofoto Ajrore Viti 1957
- Ortofoto Ajrore ITU Viti 80
- Ortofoto Ajrore Viti 1994
- Ortofoto Ajrore Viti 1999
- Ortofoto Ajrore Viti 2001
- Ortofoto Ajrore Viti 2005
- Asig-Ortofoto-8cm 2015
- Asig-Ortofoto-20cm 2015
- Ortofoto 2007
- Terren


## 2.1 Ndërveprimi me Hartën


Përveç butonave të cilët përmbajnë një funksionalitet të caktuar, në hartë mund të ndërveproni edhe duke përdorur tastierë dhe maus.


**Zoom-in:** Klikoni 2 herë në hartë dhe harta do t'ju shfaqët një shkallë më afër. Duke përdorur scroll-in e maus-it mund të bëni Zoom-in dhe Zoom-out. N.q.s. mbani shtypur butonin **SHIFT** në tastierë dhe vizatoni një dritare duke mbajtur të shtypur butonin e majtë të maus-it harta do t'ju afrohet tek dritarja që sapo vizatuat.


**Zhvendosje:** N.q.s. do të zhvendoseni në hartë nga një vend në tjetrin, duke mbajtur shtypur scroll-in e maus-it mund të lëvizni në drejtime të ndryshme të hartës.


**Ky buton**  :Jep mundësinë për të marrë informacion për një objekt duke klikuar mbi të.

**Ky buton**  :Jep mundësinë për të çuar pamjen e ekranit në të gjithë territorin që mbulon harta juaj. Shtypja e këtij butoni të sjell pamjen e të gjithë hartës në ekran(Zoom Extents).


**Ky buton**  :Jep Mundësinë të gjejme vendodhjen tonë në hartë. Duke aktivizuar këtë buton automatikisht vendodja na tregohet me pike pulsantë në qender të hartës.

**Ky buton**  :Jep mundësi që në n.q.s. klikojmë tek një rekord tek rezultatët e kërkimit harta automatikisht të beje Autozoom të gjeometria e këtij rekordi(Zoom Extents Selected).


**Ky buton**  : Jep mundësinë të marim koordinatat e një pike që duam. Duke aktivizuar këtë buton duhet të klikojme në një pike që duam dhe menjëherë do të nashfaqën koordinatat si në figurë.






Ky buton  : Jep mundësinë e matjes së distancës. Mbasi shtypni këtë buton klikoni në çdo vertëks të vijës që doni të masni. Kur doni të përfundoni matjen klikoni dy herë radhazi. Distanca tregohet në fund të vijës që keni vizatuar.





Ky buton  : Jep mundësinë e matjes së sipërfaqës. Mbasi të shtypni këtë buton klikoni në të gjitha vertëkset e sipërfaqës që doni të masni. Klikoni dy herë për të përfunduar komandën. Perimetri dhe Sipërfaqja tregohet në mes të poligonit të vizatuar.




## 2.2 Printimi


Për të printuar një pjesë të hartës me informacionin e nevojshëm, fillimisht duhet të rregulloni shtresat që doni të mbani hapur duke përdorur legjendën

dhe më pas të shypni butonin . Do të hapet një dritare sic ilustron dhe te imazhi më poshtë.


Vendosni një titull për hartën që doni të gjenëroni, vendosni një shkallë dhe më pas zgjidhni një nga Layout të shfaqur në listë. Pasi të keni përfunduar shtypni butonin .



Një mesazh me ngjyre të gjelbër do të shfaqet tek forma e printimit që tregon që printimi juaj po përgatitet si në shembull.



Pasi pdf të jetë gati, ajo do të hapet në një tab të ri në web-browserin tuaj si më poshtë.





### 2.3 Filtri Gjeografik



**Ky buton** : Jep mundësinë që të pastrosh të gjitha filtrimet gjeografike.

**Ky buton** : Jep mundësinë që të zgjidhni objektët që ndodhen brenda ose priten nga një drejtkëndësh që do të vizatoni .Mund të vizatoni më shumë se një drejtkëndësh.

**Kerko - Njje**   Raporte

Shkruaj për të kërkuar...

Regjistrimet e:

Te ndryshuara:

Numri i Njjes	Tipi
SH84Q011	Kalim ne nivel
SH84Q004	Kalim ne nivel
SH84Q005	Kalim ne nivel
SH84Q006	Kalim ne nivel
SH84Q008	Kalim ne nivel
SH84Q010	Kalim ne nivel
SH84Q009	Kalim ne nivel
SH84Q007	Kalim ne nivel

Numri i Njjes(\*):

Tip(\*):

Statusi(\*):

Description:

Vendndodhja:

Koordinata-X:

Koordinata-Y:

Koordinata-Z:


E vlefshme nga:

E vlefshme deri:


Foto/Dokument:

Shenime:

Map showing DURRËS and SHIJAK with a yellow selection box around a cluster of points.


**Ky buton**  : Jep mundësinë që të zgjidhni objektë që priten nga një pike.


Numri i Njjes(\*):  
 Tipi(\*):  
 Statusi(\*):  
 Description:  
 Vendndodhja:  
 Koordinata-X:  
 Koordinata-Y:  
 Koordinata-Z:  
 E vlefshme nga:  
 E vlefshme deri:  
 Ngarko  
 Foto/Dokument:  
 Shenime:

**Ky buton**  : Jep mundësinë që të zgjidhni objektët që ndodhen brenda ose priten nga një poligon që do të vizatoni .Mund të vizatoni me shumë se një poligon.

Numri i Njjes(\*):  
 Tipi(\*):  
 Statusi(\*):  
 Description:  
 Vendndodhja:  
 Koordinata-X:  
 Koordinata-Y:  
 Koordinata-Z:  
 E vlefshme nga:  
 E vlefshme deri:  
 Ngarko  
 Foto/Dokument:  
 Shenime:




**Ky buton**  : Jep mundësinë që të zgjidhni objektët që priten nga një vijë që do të vizatoni. Mund të vizatoni me shumë se një vijë.



**Butonat e editimit të gjeometrisë shpjegohen më poshtë me hollesi në kapitullin e editimit E. EDITMI faqja 17**

## 2.4 Shpërnda


Nëse duam të shpërndajmë një informacion si vendodhjen e një objekti në hartë si dhe atributet e tij mjafton që të kopjojmë adresën [\(link-un me njëjtrë blu në figuren më poshtë\)](#) dhe ta bejme paste në e-mail apo rjete sociale dhe personi i cili e hap adresën i shfaqët enjëjta pamje që kemi kopjuar në fillim.






### 3 LEGJENDA


#### 3.1 Legjenda

**Ky Tab**  :Ka si funksion të tregojë apo të fshehë legjendën. Legjenda është e përberë nga shtresat (Layer-at) dhe nënshtresat e saj sipas përdorimit që i kemi dhënë një objekti. Duke hapur dhe mbyllur këto shtresa mund të përfitojmë harta sipas përdorimit që në duam.



#### 3.2 Transparenca


Transparenca jep mundësinë të bëhet një lejer i tëjdukshëm. Duke klikuar mbi shtresën që duam, poshtë tij shfaqët niveli i tëjdukshmërisë si në figurë. Duke ulur apo ngritur transparencën përcaktojmë nivelin e tëjdukshmërisëq për të parë lejerin më poshtë. Klikojmë përseri mbi lejer për të fshehur nivelin e transparencës. Kujdes: Shtresa (Lejeri) do të ngelet në atë nivel tëjdukshmërie të përcaktuar më parë për sa kohë nuk rifreskohet faqja ose të dalim nga aplikacioni.



## 4 KERKIMI

### 4.1 Kërkimi i Shpejtë

Kërkimi i shpejtë është një kërkim i paracaktuar nga administratori që një përdorues mund të kërkojë vetëm në baze të fushave që ka përcaktuar administratori. Në rastin e nyjes kemi fushat (Numri i Nyjes, Tipi, Statusi, Vendndodhja). Të kësaj lloji kërkimi nuk është e nevojshme që të shkruajmë fjalinë ose fjalën e plotë të një fushe të caktuar por dhe me kombinime ose shkurtime p.sh. (SH2 Kal Ek Orgjos) si në figurën më poshtë. Të kësaj rezultate të kërkimit do të shfaqet rekordi që ka karakteristikat e mësipërme.




### 4.2 Kërkimi i Avancuar

Për të kërkuar objektet në mënyrë të avancuar të kësaj forme e kërkimit shtypim butonin

dhe do të hapet një formë si në figurë.

Ky lloj kërkimi të lejon që të bësh kombinim kërkimesh dhe me pas ti eksportosh ose ti editosh të dhënat e shfaqura të kësaj rezultate. N.q.s. duam të zgjedhim Nyjet të tipit [Kalim në nivel (level Crossing)] zgjedhim tipin si në figurë dhe më pas shtypim butonin

më pas shtypim butonin **Apliko filtrin**. Të kësaj rezultate do të shfaqen të gjitha Nyjet



të tipit [Kalim në nivel(levelCrossing)]. Klikojmë mbi butonin dhe mbyllet forma e kërkimit të avancuar, dukë na lejuar që të vazhdojmë me operacione të tjera si editimi dhe eksporti. N.q.s. duam të zgjedhim 2 tipe të ndryshme p.sh. Kalim në

nivel(levelCrossing) dhe Pike bashkimi (junction) tëk tipi i shtojmë me butonin të dyja këto vlera. Tëk rezultatët e kërkimit do të kemi Nyje të të dyja tipeve që kemi zgjedhur. E njëjta gjë mund të bëhet për të gjitha kolonat që janë lista fikse.

Nëse duam të kërkojmë të dhëna të tipit numër ose datë duhet të kemi parasysh që aplikacioni na jep mundësinë që të kërkojmë me interval. P.sh. nëse duam të kërkojmë të gjitha nyjet që ndodhen në koordinatën X: 410000 atëherë tëk forma te atributi **Koordinata X:**, duhet të vendosim vlerat 409999 dhe 410001. Nëse duam të kërkojmë të gjitha nyjet e vlefshme në datën 14/02/2016 atëherë te atributi **E vlefshme nga:** duhet të vendosim vlerat 13/02/2016 dhe 15/02/2016.


Kërkimi i avancuar të jep mundësinë dhe të kombinimit të vlerave. P.sh nëse duam të gjitha nyjet e vlefshme pas datës 14/02/2016 të tipit “Kalim në nivel” atëherë te forma e kërkimit vendosim vlerat sipas figurës me poshtë:

*E njëjta logjikë kërkimi mund të përdoret për të gjithë atributët që ndodhen në tabelë.*

### 4.3 Raportë Fikse

Për një pjesë të raportëve më të rëndësishme që kërkohen në mënyre të vazhdueshme nga përdoruesit për të monitoruar performancën e aktivitetëve apo të popullimit të të dhënave, sipas kërkesës së përdoruesit krijohen raportë fikse që me një komande krijohet raporti i dëshiruar i cili është i përditësuar më të dhënat e momentit në të cilin shtypet komanda “Eksport”.


Per të bere raportë të ndryshme në lidhje me informacionin që ndodhet në hartë klikoni te tab **Raporte**, te seksioni i Kerkimit dhe Raportimit.




Pasi të keni klikuar do tju shfaqët tabela **Raportë** si me poshtë:


Në anën e majtë të tabelës **Raportë** do të keni një listë me disa prej raportëve, klikoni mbi njërin prej tyre dhe në anën e djathtë të tabelës do tju shfaqen rezultatet si më poshtë:

Rajoni	Numri total i Tombinc	Gjatesia totale e total i Tombinc	Numri totale e total i Urave	Gjatesia totale e total i Urave(m)	Numri totale e total i Linjave- Elektriki	Numri totale e total i Linjave- Elektrik	Numri totale e total i Linjave- te-UK(m)	Gjatesia totale e total i Tunelevi	Numri totale e total i Mureve	Gjatesia totale e total i Mureve(m)	Numri totale e total i Viadukti	Gjatesia totale e total i Viadukti	Numri totale e total i Bokseve	Gjatesia totale e total i Bokseve	Numri totale e total i Barriera	Gjatesia totale e total i Barriera(m)
DRJ-Gjir 4	8340.77	2	8448.4				3	4722.7	10	8802.6						
DRQ-Tir 1	56.11	2	258.7													
DRV-Shi		9							1	19276.5						

Për ti eksportuar këto rezultate klikoni te butoni  i cili ndodhet mbi tabelën e rezultateve dhe automatikisht do të eksportohet një dokument i tipit excel.

#### 4.4 Eksporti

Pas një operacioni kërkimi që mund të kemi bërë me një nga mënyrat e kërkimit përdoruesi ka të drejtë të eksportojë të dhënat në format Excel duke klikuar mbi butonin  dhe automatikisht do të ruhen në kompjutërin tuaj.





The screenshot shows a web interface for search results. At the top, there are tabs for 'Kerko - Nyje' and 'Raporte'. Below the tabs is a search bar with the placeholder text 'Shkruaj per te kerkuar...'. To the right of the search bar are icons for a dropdown arrow, a magnifying glass, and a refresh button. Below the search bar are two dropdown menus: 'Regjistrimet e' with the value 'Te gjithëve' and 'Te ndryshuara' with the value 'Kurdohere'. Below these are three buttons: 'Shfaq te gjitha', 'Hiq filtrat', and 'Eksport'. At the bottom, there is a table with two columns: 'Numri i Nyjes' and 'Tipi'. The table contains two rows of data.


Numri i Nyjes	Tipi
SH22V003	Kalim ne nivel ^
SH22V004	Kalim ne nivel




## 5 EDITIMI

### 5.1 Butonat e Editimit të Gjeometrisë



Duke zgjedhur një rekord tëk rezultatet e kërkimi të cilat u shfaqën duke përdorur një nga operacionet e mësipërme të kërkimit, do të mbushet forma e editimit me atributët përkatëse. Ndryshojmë fushat përkatëse n.q.s. duam ti ndryshojmë. Ose me butonin  modifikojmë gjeometrinë, më pas klikojmë butonin  dhe të dhënat ruhen në server.





**Butoni  (Zgjidh gjeometrinë):** ka si qëllim përzgjedhjen e llojit të gjeometrisë në rastet kur objekti ka më shumë se 1 gjeometri. Mund të jetë e tipit (Pik, Vij, Plg). Në rastet kur objekti ka vetëm një gjeometri ky buton nuk do t'ju shfaqët.


**Butoni  (Shto/Modifiko gjeometrinë):** ka si qëllim shtimin e gjeometrisë së një objekti me gjeometri ose modifikimin e gjeometrisë. Në rastët kur objekti ka me shumë se 1 gjeometri zgjedhim gjeometrinë me butonin  me pas e ndryshojmë me butonin .



**Butoni  (Zhvendos gjeometrinë):** ka si qëllim zhvendosjen e një geometrie. Zgjedhim objektin me një nga mënyrat e kërkimit ose të filtrit geografik, shtypim butonin  dhe çojme kursoren mbi geometri. Duke e mbajtur shtypur butonin majtas të mouse zhvendosim objektin, dhe me pas ruajme ndryshimet.



**Butoni  (Dubliko objektin):** ka si qëllim dublikimin e një objekti të caktuar duke e zhvendosur objektin e ri 10 m më larg, për të pasur mundësinë e zhvendosjes.






Pasi shtypim butonin do të hapet një tabelë si në figurën më sipër që të jep mundësinë e ndryshimit të atributëve të objektit të ri pasi e keni zgjedhur te lista duke klikuar **Hap editor-in** para se të dublikosh objektin.

Zgjedhim objektin dhe me pas klikojmë **Dubliko**. Një objekt i ri do t'ju shfaqet në hartë 10 metra më larg.


**Butoni  (Offset objektin):** mundëson krijimin e një objekti të ri paralel me objektin e parë në një nga anët e parapërcaktuara.







The screenshot displays the GIS application interface. On the left, there is a metadata form for an existing road object. The main map area shows an aerial view with a road segment highlighted in blue. A green line represents the offset road. A dialog box 'Distanca 50' is open, allowing the user to set the offset distance. Another dialog box 'Rruge (Seksion) 5' is open, showing the attribute form for the new object. The attribute form includes fields for ID, name, classification, and coordinates.


1) Selektujmë objektin, 2) aktivizojmë butonin **Offset**, 3) duke klikuar përcaktojmë nga cila anë duam të bëhet offset, 4) nëse duam një largësi të caktuar vendosim vlerën në metra te **Distanca**, 5) nëse duam që objekti i ri të ketë atributë të ndryshme nga i pari klikojmë butonin **Edito** dhe ndryshojmë. 6) Klikojmë butonin **Offset** dhe objekti i ri shfaqet automatikisht sipas kërkesave të parapërcaktuara.

**Kujdes:** Nëse nuk e ndryshojmë **Distancën**, objekti krijohet paralel në lagesinë që ka pika nga objekti.


**Butoni  (Ndaj gjeometrit):** ka si qëllim ndarjen e një gjeometrie në dy gjeometri të ndryshme duke ruajtur të njëjtat atributë për të dyja.





Zgjedhim objektin me një nga mënyrat e kërkimit ose të filtrit gjeografik, shohim që butoni  behet aktiv. Vizatojmë një vijë e cila e ndan objektin në dy pjesë dhe me pas shtypim butonin  N.q.s. pozicioni që e keni ndare nuk është i saktë para se të ruani ndarjen shtypni butonin  dhe vizatoni nga e para vijën që ndan objektin.

**Butoni  (Bashko gjeometrit):** ka si qëllim bashkimin e disa gjeometrive në një duke pasur mundësinë e zgjedhjes së atributëve të një objekti të caktuar dhe gjeometri shumë të gjeometrive të objektëve të zgjedhura.


Zgjedhim objektin me atributët që duam (në rastin tonë 995) dhe me pas klikojmë **Bashko**. Për tu siguruar që kemi zgjedhur apo jo atributët e dëshiruara klikojmë **Hap editor-in**.




**Butoni  (Fshij gjeometrinë):** ka si qëllim

fshirjen e gjeometrisë se objektit pasi objekti është përzgjedhur. Ky buton fshin vetëm gjeometrinë e objektit dhe jo të të dhënave të tjera. Në rastet kur keni bërë një gjeometri gabim dhe, ta modifikosh është me e vështire sesa ta krijosh nga e para atëherë fshini gjeometrinë me butonin  dhe shtoni përsëri me butonin .

## 5.2 Importi Shapefile

**Butoni  (Import gjeometrinë):** Ka si qëllim importin vizual të një skedari të formatit **gpx** ose **shapefile** në hartën e aplikacionit.

Shtypim butonin **Lexo Skedar me Gjeometri** dhe zgjedhim tipin e skedarit **GPX** shtypim **Ngarko** dhe zgjedhim skedarin **GPX**, automatikisht projekti do të shfaqet në hartë.





Për të impirtuar një skedar të tipit **shapefile** zgjedhim tipin **SHAPE** më pas na hapet tabela ku duhet të percaktojmë sistëmin koordinativ në të cilin është skedari, p.sh **ETRS89 Albania TM 2010** më pas shtypim butonin ngarko dhe zgjedhim skedarin në formatin **shapefile (.shp)** dhe automatikisht projekti do të shfaqet me njgjyrë blu në hartë i konvertuar në sistëmin në të cilin harta operon.




Shtypim butonin Fshi Gjeometrinë e Importuar për të larguar projektin nga harta.

\*Konvertimi i projektit në sistemin që operon hartë nuk bën asnjë ndryshim në vetë projektin apo në sistemin në të cilin është ruajtur projekti orgjinal dhe është vetëm për sa kohe projekti është në program.

### 5.3 Eksporti Shapefile

**Butoni**  **Eksporti i Gjeometrise (Export Shape)** mundëson ruajtjen të një apo më shumë gjeometrive të një lloj objekti në formatin *shapefile*. Pasi kemi zgjedhur me një nga mënyrat e selektimit objektët, shtypim butonin **Export Shape**  ku hapet tabela për të zgjedhur se në cilin sistem koordinativ duam ta ruajme gjeometrinë p.sh **WGS 1984 UTM Zonë 34N** si në shembullin më poshtë.



The screenshot shows a web-based GIS interface. On the left, there is a form with the following fields:

- Vendndodhja: [Empty text box]
- Koordinata-X: 371886.592
- Koordinata-Y: 4575130.224
- Koordinata-Z: [Empty text box]
- E vlefshme nga: [Dropdown menu]
- E vlefshme deri: [Dropdown menu]
- Foto/Dokument: [Text box with a 'Ngarko' button]
- Shenime: [Text box]

On the right, there is a map view with a yellow box highlighting a specific area. A dialog box is open over the map, titled 'Zgjidh sistemin për të exportuar'. It contains a list of coordinate systems:

- WGS 1984 UTM Zone 34N (highlighted)
- Pulkovo 1942 GK Zone 4N
- KRGJSH 2010
- Albanian 1987 GK Zone 4

Below the list is a 'Fillo exportin' button.

Shtypim butonin **Fillo exportin** dhe automatikisht gjeometri do të ruhen në kompjuter në formatin *zip*.